



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

DREJTORIA LIGJORE

DREJTORIA E URBANISTIKËS, PLANIFIKIMIT URBAN DHE ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT

PROJEKTVENDIM

NR____, DATË__/_/202__

PËR

MIRATIMIN E HARTËS SË VENDQËNDRIMEVE TË MJETEVE LUNDRUESE
DHE KORRIDOREVE TË LËVIZJES SË TYRE NË TERRITORIN E
BASHKISË DURRËS

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, sipas relacionit për gatitur nga Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e hartës së vendqëndrimeve të mjeteve lundruese dhe korridoreve të lëvizjes së tyre në territorin e Bashkisë Durrës, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit, pranë Bashkis Durrës për ndjekjen e procedurave të mëtejshme sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtore

Alinda Rroshi

DREJTORIA E URBANISTIKËS, PLANIFIKIMIT
URBAN DHE ZHVILLIMIT TERRITORIT

Drejtore

Ana Hoxha

KRYETARE

Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

**DREJTORIA E URBANISTIKËS, PLANIFIKIMIT URBAN DHE ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT**

Nr. ____ prot.

Durrës, më _____. 2026

RELACION

PËR

**MIRATIMIN E HARTËS SË VENDQËNDRIMEVE TË MJETEVE LUNDRUESE
DHE KORRIDOREVE TË LËVIZJES SË TYRE NË TERRITORIN E
BASHKISË Durrës**

Të nderuar këshilltarë !

Me Vendimin nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, Këshilli i Ministrave ka miratuar Rregulloren “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.

Në nenin 4 të kësaj rregulloreje përcaktohet se:

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përgatisin hartën e përgjithshme për plazhet e lejuara. Kjo hartë përmban, si më poshtë vijon:
 - a) hapësirat e plazhit për të ushtruar veprimtari, si stacion plazhi;
 - b) hapësirat e plazhit publik;
 - c) hapësirën ujore të lejuar për notim, zonë e rrethuar me bova;
 - ç) vendqëndrimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre.
2. Për përcaktimin e vendqëndrimeve dhe korridoreve të lëvizjes, të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe me strukturat e Policisë Kufitare.

Harta e përgjithshme e plazheve propozohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe miratohet brenda muajit tetor nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik.

Në nenin 6 të kësaj rregulloreje përcaktohet se:

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore (në vijim “NJVV”) është përgjegjëse, për:

- a) administrimin dhe menaxhimin e hapësirave të plazhit publik;
- b) pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të plazhit;
- c) pajisjen me infrastrukturën mbështetëse dhe ndarjen me sinjalistikën përkatëse të plazheve, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ç) vendosjen e sinjalistikës së dallueshme për çdo tipologji plazhi, që është plazh publik;
- d) mbledhjen e detyrimeve të qirasë për çdo vit;
- dh) miratimin e vendqëndrimeve të mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre, pasi të ketë marrë mendimin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, referuar edhe kërkesave të subjekteve të ndryshme, Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit ka përgatitur hartën e vendqëndrimeve të mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre në territorin e Bashkisë Durrës duke marrë edhe mendimin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe strukturës së Policisë Kufitare.

Nga sa më sipër kërkojmë:

Miratimin e hartës së vendqëndrimeve të mjeteve lundruese dhe korridoreve të lëvizjes së tyre në territorin e Bashkisë Durrës, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

Ju falenderojmë paraprakisht për mirëkuptimin,

**DREJTORIA E URBANISTIKËS, PLANIFIKIMIT
URBAN DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

Drejtore

Ana Hoxha
